



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**  
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Nr. 2320 Prot

Tiranë, më 20 06 /2022

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

**DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN**

**KËTU**

**DREJTORISË RAJONALE TË OFRIMIT TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK**  
**ELBASAN**

Mbështetur në Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.554 datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 14, datë 27.5.2021 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, Urdhërin e Kryeministrit nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, i ndryshuar, ju njoftojmë shpalljen për lëvizje paralele të pozicionit, si më poshtë:

**Pozicioni i punës:**

- Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Ofrit të Formimit Profesional Publik, Elbasan

Kandidati aplikues për pozicionin e punës: Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Ofrit të Formimit Profesional Publik, Elbasan, duhet të përmbushë kriteret si më poshtë:

**1. Kriteret të përgjithshme:**

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar.

## 2. Kriteria të posaçme:

- a) të ketë diplomë të studimeve universitare master i shkencave (ose të barasvlershëm me të), në një nga profesionet që lidhet me fushat e kualifikimeve profesionale të ofruesit të AFP-së;
- b) të ketë jo më pak 5 (pesë) vjet përvojë pune në menaxhim, në sistemin e AFP-së ose fusha profesionale, në përputhje me kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së;
- c) të ketë njohuri të certifikuara të përdorimit të teknologjisë së informacionit;
- d) preferohet të ketë njohuri të gjuhës angleze dhe/ose të gjuhëve të huaja të tjera.

## 3. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në), i cili plotësohet sipas formatit në shtojcën 11 të Udhëzimit nr.14 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë;
- c) kartën e identitetit
- d) diplomën
- e) librezën e punës
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në jetëshkrim;
- g) certifikatë/a ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre.  
Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

Afati i njoftimit fillon më datë 20.06.2022.

Njoftimi bëhet në faqen zyrtare të AKPA-së, në faqen elektronike zyrtare të Drejtorisë Rajonale të Ofrimit të Formimit Profesional Publik Elbasan (nëse ka), si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të Drejtorisë Rajonale të Ofrimit të Formimit Profesional Publik, Elbasan.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të Drejtorisë Qendrore të AKPA-së, brenda datës 27.06.2022.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**Klevis HYSA**

